



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 958/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Validohet** akreditimi ndërkombëtar i Kolegjit Heimerer në nivel institucional për periudhën 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
- II. **Validohet** akreditimi ndërkombëtar i programit të studimit të Kolegjit Heimerer për periudhën 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
 1. *Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc 120 ECTS*, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji Heimerer që deri me datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji Heimerer që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovet nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji Heimerer në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për validim të akreditimit në nivel institucional dhe të programeve të studimit të cekura në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të certifikatave dhe dëshmimeve të ofruara rreth akreditimit të këtij institucioni nga Agjencia EVALAG, e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA).


Për programin e akredituar sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi, KSHC ka aprovuar listën e bartësve si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, 120 ECTS, Validim	Samir Lleshi Bernard Tahirbegolli Ilir Hoxha Liridon Kryeziu

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Heimerer;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilir
Kryetare e Këshillit Shtetëror

